

# *Religjioni i identitetit në Kosovë: praktikat historike dhe bashkëkohore të pelegrinazhit*

“Identiteti etnik nuk është diçka i pandryshueshëm, ndërsa popujt dhe kombet nuk janë entitete të izoluara dhe të ndara”. Ka vetëm pak vende në Evropën e sotme ku një deklaratë e tillë mund të jetë kundërthënëse në masën në të cilën ajo është në Kosovë. Megjithatë, atë e ka thënë antropologu kulturor holandez, Ger Duijzings, në librin e tij të botuar në vitin 2000, pikërisht i pajisur me përvojën e punës etnografike me bashkësitë fetare në Kosovë. Studimi i Duijzingsit “Religjioni dhe identiteti në Kosovë” është shkruar në bazë të hulumtimeve në terren, të cilat autori i ka kryer në fillim të viteve ‘90 të shekullit 20, kur Kosova ishte nën kontrollin e fortë të regjimit në Beograd, dhe shumë fenomene të cilat ai i përshkruan në libër më nuk ekzistojnë. Por, punimi i tij paraqet një dëshmi të përhershme për një Kosovë tjetër fare dhe për nevojën që në këto hapësira të mendohet jashtë fotografive bardhezi për armiqtësinë e dy bashkësive etnike. Historia e Kosovës si histori e “urrejtjeve të vjetra etnike”, konfliktit të dy bashkësive të ndara qartë të cilat i ndajnë prejardhja, gjuha dhe feja, duket si një lloj perde maskuese e cila fsheh procese të ndërlikuara dhe të ndërthurura të koegzistencës dhe lëvizjeve përtej kufijve të bashkësive etnike dhe fetare, qoftë falë tregtisë dhe shkëmbimit kulturor, qoftë falë konvertimit fetar. Kjo pamje tjetër fare flet për Kosovën si një shoqëri pluraliste në të cilën kanë bashkëjetuar grupe të ndryshme etnike, ku është folur me shumë gjuhë dhe në të cilën kanë qenë të përfaqësuara të gjitha religjionet e mëdha të Ballkanit.

Pikënisje për studimin e praktikave hibride etnike dhe fetare në Kosovë mund të jenë pelegrinazhet. Është paksa absurde, edhe pse pelegrinazhet janë ngjarje të rrënjësura fort në religjionin e caktuar dhe nënkuptojnë besimin në fuqinë shëruese të shenjtorëve të veçantë, në nivelin lokal ato sipas rregullit gjithmonë kanë përfshirë pjesëtarët e bashkësive të ndryshme fetare, qoftë nëse bëhet fjalë për individë që kërkonin shërim, qoftë nëse bëhet fjalë për njerëz që thjesht donin të ishin pjesë e një tubimi vjetor. Kur më 1992 Duijzings vizitoi fshatin Letnicë në Komunën e Vitisë, në juglindje të Kosovës, aty gjeti vetëm mbetjet e një ngjarjeje të madhe tradicionale që zakonisht çdo vit mblidhte mijëra pelegrinë me përkatësi të ndryshme etnike dhe fetare.

Caku i pelegrinëve ishte faltarja katolike, kisha e bardhë e Zojës së Letnicës, një qendër kjo fetare dhe kulturore e kroatëve të Kosovës. Por, në pelegrinazh nuk merrnin pjesë vetëm kroatët dhe shqiptarët katolikë, por edhe romët, të cilët kryesisht ishin myslimanë, por edhe serbët ortodoksë dhe shqiptarët myslimanë. Identiteti i kroatëve kosovarë sipas rregullit lidhej me koloninë e minatorëve dhe tregtarëve, që në mesjetë kanë ardhur në Kosovë nga hapësira e Dubrovnikut dhe e Dalmacisë për t’u bërë pjesë e këtyre aktiviteteve ekonomike, dhe që gëzonin mbrojtjen e sun-

---

\* Autori ka doktoruar muzikologjinë në Beograd dhe punon në Institutin Muzikologjik të Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Serbisë si bashkëpunëtor shkencor. Libri i tij i parë “Vënia në hartë e Serbisë së Vjetër: hapave të udhëpërshkruesve, gjurmëve të këngës popullore”, është botuar sivjet në edicionin e bibliotekës “Shekulli XX”.

dimtarëve mesjetarë të këtyre anëve. Por, siç vëren Duijzings, identiteti etnik dhe fetar në rajonin e Letnicës është aq shumë lëvizës, jostabil dhe ndryshues, sa që vështirë është të shpjegohet thjesht vetëm me migrimet që thuhet se kanë ndodhur para shtatë shekujsh.

Pelegrinazhet në Letnicë dhe kulti marjanik, mbi të cilin është bazuar kjo me gjasë ka nisur vetëm nga fillimi i shekullit 19, me gjasë me ndërtimin e kishës së re luksoze në vitin 1886, dhe atë duhet shikuar në kontekstin evropian të reagimit konservator katolik ndaj lëvizjeve moderne politike. Interesante është që, në fshatrat rreth Letnicës, para së gjithash në Stubllë dhe Binçë, që kanë qenë të përziera katolike-shqiptare, kanë mundur të gjinden bashkësitë e të ashtuquajturve “laramanë”, të cilët nuk janë as katolikë e as myslimanë, por bashkëdyzim i të dyjave. Në fakt, shumë shqiptarë në këto fshatra e kanë pranuar islamin vetëm nga fillimi i shekullit 18, por konvertimi i tyre, sipas mendimit të priftërinjve shqiptarë-katolikë ka qenë vetëm nominal: duke u shndërruar në të ashtuquajtur “kripto-katolikë”, ata në sferën publike kanë simuluar identitetin mysliman ashtu që të shmangin shtypjen otomane, por në hapësirën e shtëpive të tyre dhe familjes kanë mbajtur identitetin dhe praktikat fetare të paprishura. Kur në vitin 1845, të nxitura nga kleri i tyre katolik, 25 familje shqiptare nga Stublla publikisht hoqën dorë nga islami dhe u kthyen në krishterim, ata u dëbuan në Anadoll, ku gjatë tre vjetëve të ekzilit vdiqën gati njëqind prej tyre, dhe në narrativen katolike mbetën të kujtuar si “Martirët nga Stublla”. Por, siç zbulon Duijzings, në këtë pjesë të Ballkanit dhe Kosovës asgjë nuk është ashtu siç shfaqet, e posaçërisht jo identiteti etnik dhe ai fetar. Me qasje në burimet historike, ky antropolog holandez konkludon se narrativi për kriptokatolicizmin në Letnicë në fakt nuk ka qenë një praktikë e gjallë e ruajtur, porse është sajuar si konstrukt i kishës katolike, përmes të cilit ajo është përpjekur të ridefinojë identitetin e njerëzve që kishin ndjenja të papërcaktuara të përkatësisë fetare dhe të arsyeve politike e ekspansionit katolik. Situatën edhe më shumë e ndërlikon fakti që shumë katolikë nga këto fshatra, që janë deklaruar si kroatë edhe gjatë shekullit 20, megjithatë, kanë folur gjuhën shqipe, kanë bartur veshje tradicionale shqiptare, kanë respektuar traditat patriarkale dhe kanë mbajtur lidhje martesore me shqiptarët. Në fund, vetë Duijzings ishte dëshmitar i sipas të gjitha gjasave kapitullit të fundit në historinë e kroatëve të Kosovës – nën presionin e politikës nacionaliste serbe nga njëra anë, dhe lidhjes së re të formuar mes kishës katolike dhe shtetit të pavarur kroat në anën tjetër, gati të gjithë kroatët kosovarë, më shumë se 2.200 veta migruan në vitet 1992 dhe 1993, me dhjetë konvoje autobusësh, për në Kroaci, duke u vendosur atje nën mbrojtjen e shtetit në rajonin e Sllovonisë perëndimore, në fshatra dhe shtëpitë e boshatisura nga lufta, prej të cilave pak kohë më parë kishin ikur serbët.

Faltoret e krishtera ortodokse në Kosovë po ashtu kanë joshur pelegrinë jo-ortodoksë: Gračanica, Zoçishte, Deviçi, Deçani, por edhe manastiri Ostrog në Mal të Zi, të cilin po ashtu e vizitonin myslimanët nga Kosova. Shumë prej këtyre manastireve në fund të shekullit 20 u bënë të rëndësishëm për narrativen e nacionalizmit serb, andaj



Foto: KoSëv

**Festë fetare në Manastirin në Zoçishtë**

dhe karakteri i përzier i këtyre pelegrinëve është edhe më çuditës. Në manastirin e Graçanicës, që feston ditën e Ngritjes së Virgjëreshës si festë të veten, numër i madh i myslimanëve-romë zaptonte tokën e manastirit dhe festonte këtë festë bashkë me pelegrinët serbë. Në mesin e tyre kishte të sëmurë dhe gra që s'mund të lindnin apo edhe shtatzëna, që rëndom vinin në përcjellje të anëtarëve të familjeve të veta dhe kalonin natën te porta e manastirit, duke besuar që kjo do të përshepte rimëkëmbjen e tyre apo do t'u ndihmonte të mbeten me barrë. Por, shumicën e të pranishmëve i joshte mundësia që të kalojnë kohë të mirë, me kafenetë përreth që organizonin muzikë dhe hapësirë për vallëzim dhe me tregtarët të cilët hapësirën te muret e manastirit e shndërronin në një lloj panairi të improvizuar. Manastiri Zoçishtë, në afërsi të Rahovecit, është nga mesjeta, dhe besohet se kjo faltore posaçërisht ndihmon në rastet e sëmundjeve të syve dhe çrregullimeve psikosomatike. Kisha e manastirit u është e dedikuar "magjistarëve të shenjtë", shenjtoreve-shërues Kuzmanit dhe Damjanit, por për dallim nga ai në Graçanicë, kjo është një ngrehinë e thjeshtë dhe modeste. Deri nga fundi i viteve '80 të shekullit 20, shumë myslimanë shqiptarë nga Zoçishtit, sikur edhe nga Rahoveci, kanë ardhur në manastir për të përcjellë festimet e tubimit që mbahej çdo vit më 14 korrik, e në disa raste edhe ishin më të shumtë sesa serbët. Rritja e nacionalizmit serb dhe ardhja në pushtet në Serbi e Slobodan Milosheviqit, heqja e autonomisë së Kosovës, si dhe shuarja e dhunshme e demonstratave në vitin 1989 në vetë qytetin e Rahovecit (ku më parë raportet etnike ishin mjaft harmonike), sollën deri te rritja e mosbesimit mes shqiptarëve dhe serbëve dhe i dha fund këtij pelegrinazhi "të përzier". Në festën e vitit 1991, Duijzings shënoi vetëm disa shqiptarë të moshuar dhe shumë të sëmurë që u përpoqën të vinin deri në Zoçishtë në kërkim të shërimit, bashkë me një numër myslimanësh romë, myslimanësh sllavë dhe disa turq nga Prizreni, të cilët po ashtu i ishin bashkuar tubimit. Në festën e vitit 1991 pamja në manastirin e Zoçishtit i ngjasonte tubimit në Graçanicë: afër hyrjes në portën e manastirit romët shisnin ushqim dhe lodra dhe organizonin shfaqje të thjeshta e të improvizuara panairesh, derisa brenda mureve punonte kafeneja nën qiellin e hapur, të cilën e udhëhiqnin rinia serbe nga fshati. Pelegrinët hynin në kishë dhe uleshin në gjunjë para altarit, jo rrallë shtriheshin edhe nën të gjatë natës dhe në kohën e këndimit të priftërinjve, duke besuar se kështu do t'i ekspozohen më së shumti mëshirës shëruese të shenjtoreve. Por, nacionalizmi gjithnjë e më shumë merrte hakun e tij dhe tubimi në Zoçisht fitonte kuptime të tjera dhe shndërrohej në demonstrim të pranisë serbe në atë pjesë të Kosovës: tregtarët serbë në portë shisnin plaketa dhe distinktive me portretet e politikanëve nacionalistë serbë, sikur Vuk Drashkoviqi, Slobodan Milosheviqi dhe Vojislav Shesheli, flamuj serbë dhe simbole çetnike, derisa në kafene lëshoheshin këngë çetnike, e forcat serbe fluturonin me aeroplanë mbi hapësirën e këtij rajoni. Në një takim të çuditshëm të dy bashkëkombësve, një serb që kishte ardhur nga Prizreni akuzoi një fshatar lokal se është "spiun shqiptar", sepse iu duk që në dialektin e tij të gjuhës serbe vërejtë në fakt gjuhën shqipe, gjë që ilustronte paranojën me të cilën serbët nga Kosova kishin ndaj të gjithëve që nuk janë "një prej tyre".

Manastirin e Zoçishtit e mori Ushtria Çlirimtare e Kosovës më 1998, e më pas, më 1999 kisha u minua dhe u shkatërrua. Sikur edhe praktikat dhe pelegrinazhet e tjera të ndërlikuara fetare, edhe pelegrinazhi në Zoçishtë në fund u ndërpre. Manastiri u rindërtua më 2004 me një rikonstruktim besnik të kishës së rrënuar. Praktikrat e pelegrinazhit sot sërish ekzistojnë në Manastirin e Zoçishtit. Por, aty më nuk vijnë

banorët lokalë të të gjitha besimeve, por para së gjithash serbët nga Beogradi, të cilët çdo muaj i vizitojnë Kosovën dhe manastiret më të rëndësishme të kishës ortodokse serbe. Ky udhëtim pelegrin, në të cilin edhe vetë kam marrë pjesë në vitin 2011 për qëllimet e studimeve etnografike, ka një karakter krejt tjetër krahasuar me pelegrinazhet tradicionale të përziera kosovare, të cilat identitetet etnike dhe kombëtare i vinin në plan të dytë. Organizuar nga ana e iniciativave private në Beograd, me bekimin e kishës ortodokse serbe, këto pelegrinazhe shumë qartë e ndërlidhin identitetin nacional serb dhe praktikat fetare ortodokse në një tërësi të vetme. “Pelegrinët” modernë në Kosovë e kalojnë një fundjavë, udhëtojnë me autobusë që i çojnë prej një manastiri te tjetri, ku e kanë mikpritjen e ngrohtë të murgjve dhe murgeshave, ndërsa netët sipas rregullit i kalojnë në shtëpitë e serbëve në Hoçë të Madhe apo Rahovec. Por, ata nuk i vizitojnë vetëm vendet që lidhen me religjionin e tyre, por edhe vendet komemorativet kombëtare, sikur që është përmendorja në Gazimestan, dhe në atë mënyrë plotësisht e barazojnë përkatësinë kombëtare me përkatësinë fetare. Për dallim nga pelegrinazhet tradicionale, të cilat gjithmonë kanë qenë të rrënjosura në rrethanat lokale dhe pamjen demografike të rajonit, këto praktika pelegrine pjesëmarrësve të tyre u ofrojnë një pamje të fabrikuar të realitetit: “pelegrinëve”, në fakt, nga ana e organizatorëve u është ndaluar të komunikojnë me shqiptarët, ndërsa në autobusët që i transportojnë nëpër Kosovë dhe prapa për në Beograd dëgjojnë muzikë spirituale ortodokse dhe këngë popullore patriotike. Në këtë mënyrë, këto praktika moderne të pelegrinazheve serbe në Kosovë paraqesin fazën e fundit të “nacionalizimit” të pelegrinazhit si diçka që tradicionalisht ka qenë lokale dhe që është formuar “prej së poshti”. Me të drejtë mund të pohohet se pelegrinazhet, që dikur ishin praktika të takimeve të bashkësive të ndryshme, sot i ndajnë po të njëjtat bashkësi dhe e thellojnë hendekun që ekziston mes tyre. Duke pasur parasysh historinë tjetër fare të Kosovës, ky epilog përfundimtar në procesin e ndërtimit të kombit nuk është diç me të cilën mund të pajtohemi; në këtë kuptim një shpresë vjen nga dëshmia e igumanit të manastirit Zoçishtë, nga viti 2015, i cili tha se këtë faltore sërish e viziton edhe popullata lokale shqiptare. Në fakt, në historinë e Kosovës asnjë kufi mes bashkësive, që sot na duket i pandryshueshëm dhe i përhershëm, nuk ka qenë i padepërtueshëm dhe ka ndryshuar gjatë historisë: me mësimin e gjuhës, ndërrimin e religjionit dhe zakoneve, ka qenë e mundur të lëvizen dhe kalohen kufijtë e bashkësive etnike. Këtë, kosovarët e kanë bërë vazhdimisht, përgjatë shekujve, andaj dhe mund të konkludohet se përkatësitë e sotme etnike janë shumë më tepër rezultat i proceseve kulturore dhe historike sesa “prejardhjes biologjike”. Duke pasur parasysh se në cilën masë etniciteti në Kosovë keqpërdoret për qëllime bashkëkohore politike, ky konkludim ndoshta është një prej më radikalëve (dhe më të dobishmëve) që shkenca mund t’ia ofrojë bashkësisë kosovare dhe rajonit.